
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: BONN PROJEKT SHPK me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	20.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **19.05.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BONN PROJEKT SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BONN PROJEKT SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **BONN PROJEKT SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **19.05.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimi nga Operatori Ekonomik Ankimor:

Pretendimi 1

Në kuadër të procedurës së prokurimit për furnizimin me pajisje LiDAR, pas analizës së dokumentacionit të tenderit dhe një hulumtimi të detajuar të tregut ndërkombëtar, kemi konstatuar se disa nga specifikimet teknike të përcaktuara janë kufizuese dhe jo në përputhje me realitetin e teknologjisë aktuale në treg.

Konkretisht, kërkesa për një skaner LiDAR të integruar me kamerë me rezolucion 48MP nuk përputhet me ofertat ekzistuese të prodhuesve kryesorë, pasi sistemet LiDAR zakonisht janë të pajisura me kamera me rezolucion më të ulët (rreth 20–24MP), që përbëjnë standard në industri.

Për më tepër, kufizimi që pajisja të jetë e vetme dhe me kamerë të integruar me rezolucion 48MP, pamundëson ofertimin e zgjidhjeve alternative, të cilat janë të përhapura dhe shpesh më të avancuara, si:

kombinimi i një skaneri LiDAR (p.sh. SLAM) me performancë të lartë (deri në 1,920,000 pika/sekondë), dhe një sistemi të veçantë kamerik RGB me rezolucion shumë të lartë (p.sh. 16K ≈ 130MP).

Këto konfigurime ofrojnë saktësi më të lartë dhe tejkalojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentacion.

Në këtë kuptim, konsiderojmë se:

specifikimi dhe kufizimi që në një pajisje të kemi Lidar dhe kamerë 48MP është teknikisht i pabazuar në treg, dhe kufizimi në një pajisje të vetme është në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

të rishikojë kërkesën për kamerë 48MP dhe lidar, dhe/ose të lejojë ofertimin e zgjidhjeve alternative (multi-sensor / pajisje të kombinuara), të cilat përbushin ose tejkalojnë kërkesat funksionale dhe të saktësisë.

Andaj kërkojmë nga AK që ta rishikojë këtë kërkesë e cila është e pa nevojshme dhe minimizon konkurrencën në maksimum, dhe prej Përvojave të kaluara kemi parë që kur një OE favorizohet atëherë automatikisht edhe çmimi është më i lartë i ofertes. Dhe me këtë AK bene shkelje të NENIT 1 të LPP-se pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Kërkojmë nga AK që të ketë parasysh këtë NEN dhe mos të abuzojë me fondet publike duke bërë kritere të një anshme.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë trajtim të barabartë, mos-diskriminim dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Vendosja e kriterëve shumë specifike dhe kumulative për përvojën e mëparshme bie ndesh me këto parime pasi kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë përvojë relevante në projektim të infrastrukturës, por që nuk kanë realizuar saktësisht të gjitha kategoritë dhe parametrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Ne kete raste ne e ndjem vetem të prejashtur dhe Diskriminuar nga Ak, Ju si AK dhe kerkojm te korigjohet kjo pikesipas argumentit te cilin e kemi ofruar ne pretendimin tone

Në të kundërtën, nëse pretendimet tona nuk merren parasysh dhe nuk ndërmerren masa për harmonizimin e Dosjes së Tenderit me legjislacionin në fuqi, ne do të jemi të detyruar të ndërmarrim hapat e mëtejshëm ligjorë, duke iniciuar procedurë ankese pranë organeve kompetente, përfshirë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe institucionet e tjera përkatëse, me qëllim mbrojtjen e të drejtave tona ligjore dhe sigurimin e zbatimit të drejtë të ligjit.

Pas ketyre pretendimeve kerkojm qe Kerkesa jone te mirret si e bazur dhe te mirren ne konsiderata kerkesat tona per hiqjen e kriterëve duke i respektuar Ligjet e Prokurimit, Rregulloren e KRPP-se dhe rregulat e KRROUP. Ne te kunderten jemi te detyruar qe Ankesen tone ta dergojm edhe ne Organet me te larta.

Përgjigje në Pretendimi Ankimor nga AK:

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim lidhur me specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit për furnizimin me pajisje LiDAR, respektivisht pretendimet lidhur me kërkesën për pajisje LiDAR të integruar me kamerë me rezolucion 48MP.

Pas analizimit të pretendimeve të paraqitura, Autoriteti Kontraktues refuzon kërkesën tuaj për rishqyrtim si të pabazuar për arsyet në vijim:

- 1. Përcaktimi i specifikimeve teknike është kompetencë dhe përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues.** Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe nevojat konkrete të projektit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë specifikimet teknike që konsiderohen të domosdoshme për realizimin cilësor, efikas dhe funksional të kontratës.
- 2. Kërkesa për kamerë 48MP është kërkesë funksionale dhe e arsyeshme.** Kërkesa për integrim të kamerës me rezolucion 48MP nuk është vendosur për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar cilësi të lartë të të dhënave, saktësi më të madhe në incizime dhe rezultate optimale gjatë realizimit të matjeve dhe përpunimit të të dhënave hapësinore. Autoriteti Kontraktues, bazuar në nevojat operative dhe qëllimin e projektit, ka vlerësuar se kjo karakteristikë është e nevojshme dhe proporcionale.
- 3. Ekzistenca e operatorëve ekonomikë dhe prodhuesve që ofrojnë pajisje të tilla.** Pretendimi se kërkesa është e porealizueshme ose e pazbatueshme në treg nuk qëndron, pasi në treg ekzistojnë operatorë ekonomikë dhe prodhues që ofrojnë pajisje me karakteristika të kërkuara ose ekuivalente me to. Për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet se specifikimi teknik eliminon konkurrencën apo favorizon një operator të caktuar ekonomik.
- 4. Parimet e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë nuk janë cenuar.** Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë objektive, të paanshme dhe në funksion të nevojave reale të projektit. Të gjithë operatorët ekonomikë trajtohen në mënyrë të barabartë dhe kanë mundësi të ofertojnë nëse përmbushin kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Specifikimet teknike minimale të kërkuara nuk janë përcaktuar për të favorizuar ndonjë operator ekonomik apo ndonjë prodhues të caktuar, por për të siguruar standard minimal profesional dhe teknik të pajisjeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë parametrat minimalë teknikë që i konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektivave të projektit.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kërkesat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që kërkohen.

Gjithashtu, Dosja e Tenderit nuk ndalon përdorimin e pajisjeve ekuivalente (të ngjashëm) profesionale, përderisa ato përmbushin parametrat minimalë teknikë dhe funksionalë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Prandaj, pretendimi se kriteret janë diskriminuese apo të orientuara drejt operatorëve të caktuar është i pabazuar.

Theksohet se këto kërkesa **nuk janë të lidhura me marka apo prodhues të caktuar**, por janë të bazuara në performancë dhe funksionalitet. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë çdo pajisje ekuivalente (me performancat e specifikuara në dosjen e tenderit) ose më të avancuar që përmbush këto kërkesa minimale.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe sigurimit të konkurrencës së drejtë, duke përcaktuar vetëm ato kërkesa teknike që konsiderohen të domosdoshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Prandaj, kërkesa e operatorit ekonomik për ndryshimin apo largimin e kriterëve teknike për pajisjet gjeodezike refuzohet si e pabazuar.

PËRFUNDIM

Pas shqyrtimit të plotë të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga operatori ekonomik, Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha pretendimet e ngritura janë të pabazuara dhe nuk ofrojnë argumente të mjaftueshme juridike apo profesionale për ndryshimin e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues konsideron se:

- kriteret për pajisjet teknike/gjeodezike janë vendosur mbi bazën e nevojave reale të projektit dhe synojnë garantimin e saktësisë, efikasitetit dhe cilësisë profesionale në realizimin e shërbimeve të kërkuara.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë në përputhje me objektin e kontratës, janë proporcionale, jo diskriminuese dhe të nevojshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, duke siguruar trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe transparencë në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit.

Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik **refuzohet në tërësi si e pabazuar**, ndërsa kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit mbesin të pandryshuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>